L I G J
Nr. 8957, datë 17.10.2002

PËR NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME

(Ndryshuar me ligjin nr. 9497, datë 20.3.2006; nr. 10 042, datë 22.12.2008)
(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj rregullon masat dhe politikat shtetërore për klasifikimin, nxitjen e krijimit dhe të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Neni 2

Qëllimi i këtij ligji është të ndihmojë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, nëpërmjet krijimit të një kuadri institucional, rregullator dhe financiar.

Neni 3
(Ndryshuar me ligjin nr. 10 042, datë 22.12.2008)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- "Ndërmarrje" quhet çdo subjekt, që ushtron një veprimtari ekonomike, pavarësisht formës së tij ligjore. Këtu përfshihen personat e vetëpunësuar, bizneset familjare, që merren me artizanat ose veprimtari të tjera, si dhe shoqëritë e shoqatat, që kryejnë, në mënyrë të rregullt, veprimtari ekonomike.
- "Shifër afarizmi" nënkupton shumat e faturuara nga ndërmarrja gjatë një viti, që i korrespondojnë shitjes në treg të të mirave dhe shërbimeve ofruar të tretëve.
- "Shoqëri kapitali" janë shoqëritë aksionare, që kanë për objekt investimin e kapitalit në ndërmarrjet e vogla e të mesme.
- "Investimi i kapitalit të përbashkët" është investimi i kapitalit të përbashkët në ndërmarrjet e vogla e të mesme, në çastin e krijimit të tyre ose në fazën e tyre fillestare të zhvillimit.
- "Fonde të zhvillimit rajonal" janë ato fonde, që sigurojnë mbështetje financiare për zhvillimin e rajoneve në fusha të caktuara, si: investimet në kapacitetet e prodhimit, ndërtimi dhe modernizimi i infrastrukturës, investimet në fushën e kujdesit shëndetësor dhe të edukimit etj.
- "Ndërmarrje të vogla e të mesme të reja" vlerësohen ato ndërmarrje të vogla e të mesme, të cilat janë regjistruar në QKR prej jo më shumë se 12 muajsh.

- “Biznese të pakuotuara” (“*business angels*”) janë ato sipërmarrje individuale që u ofrojnë kapital në shuma të vogla bizneseve, aty ku bankat apo fondet financiare nuk kanë interes të futen dhe këtë e ofrojnë në këmbim të një pjese të aksioneve të kompanisë.

- “Treg i lidhur” (“*adjacent market*”) është tregu i produkteve apo shërbimeve në diversifikim, të vendosura direkt sipër ose poshtë tregut përkatës.

Neni 4

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 042, datë 22.12.2008)

1. Ndërmarrjet klasifikohen në: mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla dhe ndërmarrje të mesme.

2. Kategoria e mikrondërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme (NVM) përfshin ato ndërmarrje, ku punësohen më pak se 250 veta dhe që realizojnë një shifër afarizmi dhe/ose një bilanc total vjetor jo më të madh se 250 milionë lekë.

3. Ndërmarrje e vogël quhet një ndërmarrje, ku punësohen më pak se 50 persona dhe e cila ka një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor jo më të madh se 50 milionë lekë.

4. Mikrondërmarrje quhet një ndërmarrje, ku punësohen më pak se 10 persona dhe e cila ka një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor jo më të madh se 10 milionë lekë.

5. Për qëllime statistikore ndërmarrjet do të klasifikohen në:

a) mikrondërmarrje: 0 deri 9 persona, ku brenda këtij grupimi të detajohen në 0-1 persona dhe 2-9 persona;

b) ndërmarrje të vogla: 10 deri 49 persona;

c) ndërmarrje të mesme: 50 deri 249 persona.

Neni 4/1

(Shtuar me ligjin nr. 10 042, datë 22.12.2008)

1. “Ndërmarrje autonome” quhet ajo ndërmarrje që:

a) është totalisht e pavarur dhe që nuk ka asnjë pjesëmarrje në kapitalin ose të drejtat e votës në një ndërmarrje tjetër dhe anasjelltas;

b) mund të ketë disa investitorë, të cilët zotërojnë secili më pak se 25 për qind të kapitalit apo të të drejtave të votës, por me kusht që të mos jenë të lidhur në kuptim të nenit 4/3 të këtij ligji;

c) nuk klasifikohet si ndërmarrje partnere, në bazë të kuptimit të nenit 4/2 ose si ndërmarrje e lidhur, në bazë të neneve 4/1 pika 2 dhe 4/3 të këtij ligji.

2. Një ndërmarrje mund të vlerësohet autonome edhe në rastet kur nuk ka asnjë ndërmarrje partnere, megjithëse pragu i 25 për qind të kapitalit ose të të drejtave të votës arrihet apo tejkalohet nga investitorët e mëposhtëm, me kusht që këta investitorë të mos jenë të lidhur, në kuptim të nenit 4/3 të këtij ligji:

a) personat juridikë publikë, shoqëritë e kapitalit dhe individë apo grupe individësh me një veprimtari të rregullt investimi kapital, që investojnë aksione në biznese të pakuotuara (“*business angels*”), me kushtin që totali i investimeve të këtyre bizneseve të pakuotuara (“*business angels*”), në të njëjtën ndërmarrje, të jetë më pak se 30 milionë lekë;

b) universitetet dhe qendrat kërkimore jofitimprurëse;

c) investitorët institucionalë, përfshirë fondet e zhvillimit rajonal;

ç) autoritetet vendore me buxhet vjetor më të ulët se 50 milionë lekë dhe me më pak se 5 000 banorë.

Në çdo rast, pragu nuk mund të jetë më shumë se 50 për qind e kapitalit ose e të drejtave të votës, me kushtin që investitorët e mësipërm të mos jenë të lidhur, individualisht ose

bashkërisht, me ndërmarrjen në fjalë.

Neni 4/2
(Shtuar me ligjin nr. 10 042, datë 22.12.2008)

"Ndërmarrje partnere" janë të gjitha ndërmarrjet, që nuk klasifikohen si ndërmarrje të lidhura dhe ndërmjet të cilave ekziston marrëdhënia si më poshtë:

- Një ndërmarrje zotëron vetëm ose bashkë me një apo më shumë ndërmarrje të lidhura 25 për qind apo më shumë të kapitalit ose të të drejtave të votës, por, në çdo rast, jo më shumë se 50 për qind të kapitalit ose të të drejtave të votës në një ndërmarrje tjetër.

Neni 4/3
(Shtuar me ligjin nr. 10 042, datë 22.12.2008)

"Ndërmarrje të lidhura" janë ato ndërmarrje, të cilat kanë një ose disa prej marrëdhënieve të mëposhtme me njëra-tjetrën:

a) një ndërmarrje zotëron pjesën më të madhe të aksioneve ose të të drejtave të votës në një ndërmarrje tjetër;

b) një ndërmarrje ka të drejtë të emërojë ose të shkarkojë pjesën më të madhe të anëtarëve të organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të një ndërmarrjeje tjetër;

c) një ndërmarrje ka të drejtë të ushtrojë ndikim dominues mbi një ndërmarrje tjetër, sipas kontratës, që ka lidhur me atë ndërmarrje, ose sipas një dispozite në statusin e shoqërisë;

ç) një ndërmarrje, e cila si aksionare ose anëtare e një ndërmarrjeje tjetër, kontrollon e vetme, sipas një marrëveshjeje me aksionarët ose anëtarët e tjerë të asaj ndërmarrjeje, shumicën e të drejtave të votës mbi bazë aksionesh ose anëtarësh në atë ndërmarrje.

Neni 4/4
(Shtuar me ligjin nr. 10 042, datë 22.12.2008)

1. Prezumohet se nuk ekziston asnjë ndikim dominues, nëse investitorët e listuar në pikën 2 të nenit 4/1 këtij ligji nuk përfshihen vetë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në menaxhimin e ndërmarrjes në fjalë, pa paragjykim për të drejtat e tyre si aksionarë.

2. Ndërmarrje të lidhura janë edhe ato, që kanë ndonjërën nga marrëdhëniet e përshkruara në nenin 4/3, nëpërmjet një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera apo ndonjë nga investitorëve, të përmendur në pikën 2 të nenit 4/1 të këtij ligji.

3. Ndërmarrjet, që i lidhin një ose disa marrëdhënie të tilla me një person fizik ose grup personash fizikë, që veprojnë bashkërisht, vlerësohen, gjithashtu, ndërmarrje të lidhura, në qoftë se veprimtarinë e tyre ose një pjesë të saj e ushtrojnë në të njëjtin treg përkatës ose në tregun e lidhur ("adjacent market").

4. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2 të nenit 4/1 të këtij ligji, një ndërmarrje nuk mund të vlerësohet si ndërmarrje e vogël apo e mesme, nëse 25 për qind ose më shumë e kapitalit apo e të drejtave të votës kontrollohen, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, bashkërisht ose individualisht, nga një ose më shumë organe publike.

5. Ndërmarrjet mund të deklarojnë statusin e tyre, si ndërmarrje autonome, ndërmarrje partnere ose ndërmarrje e lidhur, përfshirë të dhënat, që lidhen me tavanet e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji. Deklarata mund të bëhet edhe në rastet kur kapitali është i shpërndarë në atë mënyrë që nuk është e mundur të përcaktohet se nga kush zotërohet. Në këtë rast, ndërmarrja mund të deklarojë, në mirëbesim, se nga asnjë ndërmarrje e vetme ose nga ndërmarrje të lidhura me njëra-tjetrën bashkërisht nuk zotërohet 25 për qind apo më shumë e kapitalit.

6. Mënyra e deklarimit të statusit të ndërmarrjeve, sipas pikës 5 të këtij neni, përcaktohet me udhëzim të miratuar nga ministri përgjegjës për ekonominë.

Neni 4/5
(Shtuar me ligjin nr. 10 042, datë 22.12.2008)

1. Të dhënat, që zbatohen për numrin e të punësuarve dhe shumat financiare janë ato, që lidhen me periudhën e fundit të llogarive të miratuara dhe që llogariten në baza vjetore. Ato merren parasysh nga data e mbylljes së llogarive. Shuma e caktuar për të ardhurat llogaritet duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe taksat e tjera indirekte.

2. Kur në datën e mbylljes së llogarive ndërmarrja zbulon se, në bazë vjetore, ka tejkaluar ose ka rënë poshtë numrit të të punësuarve apo tavanit financiar, të përcaktuar në nenin 4 të këtij ligji, ajo nuk e përfton ose e humb statusin e ndërmarrjes së vogël, ndërmarrjes së mesme apo të mikrondërmarrjes, me përjashtim të rastit kur këto tavane tejkalohen për dy periudha llogaritjeje të njëpasnjëshme.

3. Në rastin e ndërmarrjeve të reja, llogaritë e të cilave nuk janë miratuar ende, të dhënat për t'u zbatuar duhet të përftohen nga një vlerësim, në mirëbesim, i bërë gjatë vitit financiar në vazhdim.

Neni 4/6
(Shtuar me ligjin nr. 10 042, datë 22.12.2008)

1. Numri i të punësuarve korrespondon me numrin e njësive vjetore të punës me kohë të plotë.

2. Puna e personave, të cilët nuk kanë punuar gjatë të gjithë vitit, puna e atyre, që kanë punuar me kohë të pjesshme, pavarësisht kohëzgjatjes dhe puna e të punësuarve sezonalë llogariten si fraksione të njësive vjetore të punës me kohë të plotë.

3. Stafi përbëhet nga:

a) punëmarrësit;

b) punëdhënësit;

c) partnerët, që angazhohen në një veprimtari të rregullt në ndërmarrje dhe që përfitojnë nga përparësitë financiare të ndërmarrjes;

ç) menaxherët – pronarë.

4. Punëtorët në stazh, femrat, para ose pas periudhës së shtatëzanisë, si dhe studentët, që angazhohen në trajnime profesionale me kontratë, nuk përfshihen në staf.

Neni 4/7
(Shtuar me ligjin nr. 10 042, datë 22.12.2008)

1. Në ndërmarrjet autonome, të dhënat, përfshirë edhe ato për numrin e të punësuarve, përcaktohen ekskluzivisht, në bazë të llogaritjeve të ndërmarrjes.

2. Duke përfshirë edhe numrin e të punësuarve, të dhënat e një ndërmarrjeje, që ka ndërmarrje partnere ose ndërmarrje të lidhura, përcaktohen në bazë të llogaritjeve dhe të të dhënave të tjera të ndërmarrjes ose, aty ku ato ekzistojnë, në bazë të llogarive të konsoliduara të ndërmarrjes, ose të llogarive të konsoliduara, në të cilat ndërmarrja është përfshirë, nëpërmjet bashkimit.

3. Mënyra e llogaritjeve të ndërmarrjeve, sipas këtij neni, përcaktohet me udhëzim të miratuar nga ministri përgjegjës për ekonominë.

Neni 4/8
(Shtuar me ligjin nr. 10 042, datë 22.12.2008)

1. Të dhënave të referuara në pikën 2 të nenit 4/7 të këtij ligji u shtohen të dhënat e çdo ndërmarrjeje partnere të ndërmarrjes në fjalë. Mbledhja bëhet proporcionalisht me përqindjen në kapital ose të drejtat e votës, cilado qoftë më e lartë. Në rast kryqëzimi aksionesh, zbatohet përqindja më e lartë.

2. Të dhënave të parashikuara në pikën 2 të nenit 4/7 të këtij ligji dhe në pikën 1 të këtij neni, u shtohen 100 për qind e të dhënave të çdo ndërmarrjeje, e cila është e lidhur, drejtpërdrejt apo tërthorazi, me ndërmarrjen në fjalë, kur këto të dhëna nuk janë përfshirë, nëpërmjet bashkimit të llogarive.

3. Për zbatimin e pikës 2 të nenit 4/7 të këtij ligji dhe pikave 1 dhe 2 të këtij neni, të dhënat e ndërmarrjes partnere të ndërmarrjes në fjalë përftohen nga llogaritë e tyre dhe të dhënat e tjera të tyre të konsoliduara, nëse ekzistojnë. Këtyre u shtohet 100 për qind e të dhënave të ndërmarrjeve, të cilat janë të lidhura me ato ndërmarrje partnere, përveç kur të dhënat e llogarive të tyre përfshihen nëpërmjet konsolidimit.

4. Për zbatimin e pikës 2 të nenit 4/7 të këtij ligji dhe pikave 1 e 2 të këtij neni, të dhënat e ndërmarrjeve, që janë të lidhura me ndërmarrjen në fjalë, duhet të përftohen nga llogaritë dhe të dhënat e tjera të tyre, të konsoliduara, nëse ekzistojnë. Këtyre u shtohen proporcionalisht të dhënat për çdo ndërmarrje të mundshme, partnere të asaj ndërmarrjeje të lidhur, përveçse kur ajo është përfshirë në llogaritë e konsoliduara, me të paktën një përqindje proporcionale me përqindjen e përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni.

5. Kur në llogaritë e konsoliduara nuk shfaqen të dhënat për numrin e të punësuarve për një ndërmarrje të caktuar, numri i të punësuarve llogaritet duke bashkuar proporcionalisht të dhënat nga ndërmarrjet e saj partnere dhe duke shtuar të dhënat nga ndërmarrjet, me të cilat ndërmarrja në fjalë është e lidhur.

6. Ministri përgjegjës për ekonominë nxjerr udhëzim në zbatim të këtij neni.

KREU II

MASAT PËR NXITJEN E KRIJIMIT DHE TË ZHVILLIMIT TË NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

Neni 5

Këshilli i Ministrave mbështet krijimin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nëpërmjet:

a) sigurimit të programeve dhe projekteve të ndryshme të mbështetjes financiare;

b) garantimit të një pjese të riskut të kreditimit;

c) zhvillimit dhe zbatimit të programeve e projekteve të asistencës teknike;

ç) shërbimeve të informacionit dhe këshillimit;

d) arsimimit, trajnimit për kualifikimin profesional, si dhe ngritjes së aftësive sipërmarrëse;

dh) programeve të nxitjes së punësimit;

e) dhënies me qira të pasurive të paluajtshme me pronësi shtetërore;

ë) ngritjes së infrastrukturës në mbështetje të këtyre ndërmarrjeve dhe nxitjes së bashkëveprimit ndërmjet tyre;

f) ngritjes së parqeve industriale dhe inkubatorëve të biznesit për zhvillimin e këtyre ndërmarrjeve;

g) veprimtarive dhe masave të tjera në përfitim të tyre, të përcaktuara me ligj.

Neni 6

1. Në kuptim të nenit 5 të këtij ligji, mbështeten me përparësi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat:

a) ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorët prodhues dhe të shërbimit;

b) ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin e industrisë;

c) krijojnë vende të reja pune;

ç) ushtrojnë veprimtarinë e tyre në prodhimin për eksport;

d) ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin e turizmit;

dh) zhvillojnë veprimtaritë në fushën e kërkimit dhe të zhvillimit;

e) ushtrojnë veprimtaritë e tyre në procesin e agropërpunimit;

ë) zhvillojnë veprimtarinë në sektorin e artizanatit.

2. Gëzojnë të drejtën e mbështetjes me përparësi të gjitha bizneset, të cilat janë në fillim të veprimtarisë së tyre dhe që zhvillojnë veprimtari në fushat e përcaktuara sipas këtij neni.

KREU III
FUSHAT E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR NXITJEN E VEPRIMTARISË SË NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

Neni 7

1. Këshilli i Ministrave, në bashkëpunim me donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare, siguron fonde:

a) për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve dhe të programeve;

b) për organizimin e kurseve të trajnimit dhe të seminareve;

c) për shërbimet e informacionit dhe këshillimit, nëpërmjet botimit të materialeve të ndryshme informative.

2. Fondet e përmendura në pikën 1 të këtij neni administrohen nga Agjencia Shqiptare e Biznesit dhe Investimeve, e cila parashikohet në kreun V të këtij ligji.

Neni 8

Këshilli i Ministrave, në bashkëpunim me donatorët, institucionet financiare, të vendit ose të huaja, të përmirësojë sistemin e kreditimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke ndërmarrë nisma të "mekanizmave financiarë" në këto drejtime:

a) në krijimin e fondit të garantimit të kredive;

b) në nxitjen e zgjerimit të mikrokreditimit dhe të kreditimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;

c) në krijimin e instrumenteve të tjera financiare, duke zgjeruar rrjetin bankar në të gjithë vendin.

KREU IV
PROGRAMET PËR MBËSHTETJEN DHE ZHVILLIMIN E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

Neni 9

Ministritë dhe institucionet përkatëse parashikojnë në programet e tyre dhe zbatojnë masa në drejtim:

a) të krijimit të vendeve të reja të punës;

b) të zgjerimit të veprimtarive eksportuese dhe të rritjes së konkurrencës ndërmjet tyre;

c) të nxitjes së investimeve;

ç) të përmirësimit të shërbimeve të të dhënave dhe të këshillimit;

d) të rritjes dhe forcimit të kualifikimit profesional dhe të aftësive sipërmarrëse;

dh) të mbështetjes dhe zgjerimit të numrit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, të cilat zbatojnë teknologji të përparuara;

e) të mbështetjes së ndërmarrjeve, të cilat janë potencial për zbatimin e standardeve të cilësisë (ISO);

ë) të mbështetjes së ndërmarrjeve që zbatojnë forma të reja programesh trajnimi e punësimi pranë vendit të punës.

Neni 10

1. Institucionet qendrore dhe ato të pushtetit vendor, brenda kompetencave të tyre, zhvillojnë programe:

a) afatmesme dhe afatgjata për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në territoret e tyre përkatëse;

b) për trajnimin dhe përmirësimin e nivelit të kualifikimit të menaxherëve dhe të punonjësve të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, në bashkëpunim me organizatat e biznesit dhe institucionet publike, dhomat e tregtisë dhe industrisë, agjencitë rajonale të zhvillimit të biznesit, Shërbimit Kombëtar të Punësimit, si dhe me organizatat e tjera.

2. Veprimtaritë e parashikuara në pikën 1 të këtij neni të bashkërendohen nga Agjencia Shqiptare e Biznesit dhe Investimeve.

Neni 11

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 042, datë 22.12.2008)

Ministri përgjegjës për ekonominë përcakton kriteret për pjesëmarrjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në këto programe, sipas neneve 9 e 10 të këtij ligji.

KREU V

KRIJIMI I AGJENCISË SHQIPTARE TË BIZNESIT DHE INVESTIMEVE

Neni 12

(Shfuqizuar me ligjin nr. 9497, datë 20.3.2006)

Neni 13

(Shfuqizuar me ligjin nr. 9497, datë 20.3.2006)

Neni 14

Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Instituti i Statistikave, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe institucionet në varësi të tyre, sipas përkatësisë, mbledhin dhe përpunojnë informacionin dhe të dhënat për veprimtarinë ekonomike dhe financiare, sipas përcaktimeve në nenin 4 të këtij ligji.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 15

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe institucionet përkatëse të nxjerrin aktet e nevojshme nënligjore për zbatimin e këtij ligji dhe për rregullimin e marrëdhënieve të parashikuara në nenet 8, 11, 13 dhe 14 të këtij ligji.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3547, datë 7.11.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu